



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **17**

Prishtinë, më 8.7.2008, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje **morën pjesë**: Lulzim Zeneli, Berat Luzha, Haset Cakolli, Kosara Nikolić, Elheme Hetemi, Zylfi Merxha, Zef Morina, , Ali Lajçi, dhe Myrvete Pantina. **Munguan** : Ibrahim Selmanaj, Selvie Halimi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Nga MBPZHR : Shefki Zeqiri, nga OSCE Blerim Vela dhe Nexhat Shatri nga Presidenca

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Drita Çarkaxhiu

Mbledhjen e kryesoi : **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për OMGJ,**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Organizmat e Modifikuar Gjenetikiisht

Kryesuesi tha se në këtë projektligj Kuvendi gjatë leximit të parë, nuk ka pasur ndonjë vërejtje të veçantë, ndaj edhe sugjeroi të shqyrtohet në këtë mbledhje nen për nen.

Komisioni u pajtua të **fshihet Neni 29** sa i përket Këshillit Etik, ndërkaq tek **neni 30** në paragrafin 1 të fshihet “dhe këshilli etik”, ngase ky këshillë nuk e ka rëndësinë për tu cekur në një ligj. Konform kësaj do të fshihet edhe **pika 9 e nenit 2**.

Nga MBPZHR u kërkua të ridefinohet neni 28 duke precizuar se çka paraqet këshilli shkencor dhe përbërjen e tij, gjithashtu të sqaroi për fjalën “Autoriteti kompetent” e cila ceket në disa vende në projekt, kush është.

Preambula dhe Neni 39 do të standardizohen sipas kushtetutës në fuqi.

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni, për të sqaruar më mirë ndonjë dilemë eventuale, kërkoi që në mbledhjen e radhës të ftohet profesori Adem Demaj lidhur me këtë projektligj. Ai në cilësinë e ekspertit do të furnizohet me projektligj dhe do të jap mendimin profesional për mbledhjen e radhës, ose do të prezantoi në mbledhje nëse konsideron të arsyeshme. Në këtë mbledhje mund të ftohet edhe ndonjë ekspert tjetër (kryesuesi sugjeroi Selim Kolgecin).

3. Të ndryshme

1. Myrvete Pantina tha se komisioni për Buxhet mendon se Projektligjin për Ushqimin duhet të shqyrtoi edhe një herë ky komision për shkak të Këshillit Shkencor , i cili këshill mund të shkaktoj implikime financiare dhe të dyfishta. Megjithatë, vazhdoi ajo, kjo është njoftim gojor, për këtë çështje komisioni për Buxhet do të njoftoi zyrtarisht këtë komision. **Lulzim Zeneli** nuk u pajtua me faktin se çështja e cekur do të krijoj implikime financiare, ngase ky ligj do të gjeneroi mjete, mirëpo edhe ai u pajtua që komisioni të pres njoftimin zyrtarë.

2. Blerim Vela njoftoi me më të rehat nga parlamenti i Holandës dhe Kroacisë, të cilët parimisht janë pajtuar me këto dy vizita që parasheh ky komision ti bëjë gjatë shtatorit, ndaj gjatë javës pritet konfirmimi përfundimtar dhe caktimi më detal i agjendës.

3. Vizita në Deçan u caktua për të hënë më 14.7.2008 , nisja nga Kuvendi në orën 9,30. Komisioni do të takohet me zyrtarët komunal në Deçan në orën 11,30 , prej nga komisioni pastaj do të vazhdoi të vizitoi vendet më të prekura të pyjeve të Deçanit. Lidhur me këtë vizitë të njoftohen zyrtarët komunal në Deçan dhe deputeti Ibrahim Selmanaj.

Mbledhja përfundoi në orën 14,35

Kryesuesi i Komisionit,
Lulzim Zeneli